



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 54, datë 15.12.2017

PËR LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME KOLONJË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" si dhe VKM nr. 958, date 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kolonjë me:

Drejtues Ligjor dhe Drejtues Teknik Z. Igli Radomi

2. Operatori Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Kolonjë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:

Njësia administrative Ersekë (Bashkia Kolonjë)

4. Kjo liçencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr. 66, datë 06.09.2018

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 54, DATË 15.12.2017 "PËR
LICENCIMIN E SH. A UJËSJELLËS KANALIZIME KOLONJË"**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë sh.a. për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 54, datë 15.12.2017, "Për licencimin e sh.a Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë";
- Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë ka aplikuar me anë të shkreses nr. 251 prot. datë 24.04.2018, për licencim për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kolonjë sh.a. plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit mbi ndryshimin e drejtuesit teknik, konkretisht:
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Drejtuesi teknik plotëson kriteret e parashikuara në Rregulloren e Licencimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 54, datë 15.12.2017 "Për licencimin e sh.a Ujësjetës Kanalizime Kolonjë " bëhen këto ndryshime:

"Drejtues Teknik Robert Hamzai"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI